



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 64 prot.

Himarë, më 26.04.2024

**PROCESVERBAL I KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË,ZBARDHUR NGA
ORGJINALI ,MBI ZHVILLIMIN E MBLEDHJES PËR MUAJI PRILL.**

**Të ftuar: nënkyetarët e Bashkisë,drejtorit e Bashkisë,administratorët e njësive të
Bashkisë,kryetarët e fshatrave.**

I. Në mbledhje marrin pjesë këshilltarët:

Elisabeta Lamaj, Dhimitër Kapaj, Mirka Gjiçali, Milto Nika, Aleks Llazari, Silva Burbo, Timoleo Gërdhuqi, Thëllëza Kokaveshi, Artionil Shirokaj, Miltiadhi Prifti, Nikolinë Laska, Fuat Mati, Qirjako Mërkuri, Afrovita Dhimojani, Gjergji Iliadhi, Lenica Kocani.

Mungon :-Artan Bala, Nertila Husi, Loreta Isufi, Maks Vlashi, Thodhori Foto
Plotësohet kuorumi i këshilltarëve.

Mbledhjen e hap Kryetari Këshillit Z. Dhimitër Kapaj, ora 10:30. **Këshilltaret Silva Burbo** dhe **Afrovita Dhimojani**:- duhet që mbledhjet e këshillit të zhvillohen në ambientet e Bashkisë dhe të ketë audio për transparenc te publiku.

Kryetari Këshillillit:- kryesia vendosi në bazë të rregullores së Këshillit neni 6, pika 2 thotë mund të zhvillohen edhe në territorin e Bashkisë

Pika 1.

Jeni dakort me miratimin e rendit të ditës?

Jemi dakort me rendin e ditës (këshilli)

Pika 2

Shqyrtimi i kërkesës së këshilltarëve të Koalicionit BF në lidhje me dy drejtorit e pastrimit “REJ SH.P.K dhe ALKO IMPEKX SH.P.K

DREJTORIA JURIDIKE MERR LEJEN E FJALËS:- Të bëj një përbledhur në cilësinë e drejtorisë ,ku do t'ju çojmë në dispozicion çdo relacion. Të gjitha kontratat janë në shërbimin publik ku firmat e pastrimit janë bërë me marrëveshje kuadër dhe është titullari kontraktuar që pranon marrëveshjen.

Këshilltari Timoleo Gërdhuqi:- jemi këtu ku kemi thirrë të dyja firmat e pastrimit ,në lidhje me shërbimin që juve i jepni komunitetit.Dua t'i drejtojë një pyetje administratorit e njësisë Horë- Vranisht,keni patur ndonjë vërejtje nga banorët rreth pastrimit?

Administratori Gramoz Balili:- që në momentin që ja filluar pastrimit kemi nga një punëtor për fshati dhe puna ka qënë korrekte,sa herë ka qënë e nevojshme na janë përgjigjur për transportimin e mbeturinave.

Këshilltarja Silva Burbo:- Duam të dimë nga ana funksionale si funksionon në lidhje me Bashkinë lidhur me mbetjet voluminoze? Drejtar drejtorisë juridike:-me kontraktorët me urdhër të kryetarit ngrihen disa persona përgjegjës për të kontrolluar punën gjatë sezonit turistik kemi disa problematika,si pjesa e koshave që është pjesë e Bashkisë,por kemi grup pune që bën kontrollin e punës së firmës.

Këshilltari Miltiadhi Prifti:- pse u hoqën nga puna punëtorët që pastrojnë fshatrat,janë bërë shkurtime.

Drejtori juridik:- ligji e thotë e kam dhënë me kontratë,dhe privati ka punonjësit e tyre,nuk do të mbajnë edhe punonjësit e Bashkisë,punonjësit që janë heq kanë të bëjnë me gjelbërimin,pastrimi ka të tjerë punonjës.

Drejtori Shërbimeve Publike Sokrat Kreku:-pastrimi i varrezave dhe gjelbërimi kanë kaluar në sektor privat,punëtorët e gjelbërimit janë veç dhe të pastrimit të fshatit janë veç.

Këshilltarja Lenica Kocani:- Kush i mbulon kazanët sepse nuk janë çuar në epiketa të caktuara,kazanët janë pa rrøta ,jo të mirëmbajtur,kjo është përgjegjësi e Bashkisë.

Këshilltari Fuat Mati :-mirëmnajtjen e varrezave kjo kompani e ka?

Drejtoria juridike:- është e dhënë me kontratë firmës Alko Impex sh.p.k

Këshilltari Fuat Mati:- si trajtohen varrezat e fshatit ,janë dhënë me kontratë në muajin mars dhe miratohet me efekt dypalësh,me marrëveshjen e Bashkisë Himarë?

Zyra juridike:- po.

Këshilltarja Afrovita Dhimojani:- e lejon ligji kontratën me 36 muaj? Zyra juridike:- po e lejon.

Alko Impex sa është vlera e pastrimit për këtë kompani dhe sa makina pastrimi janë në shërbim ? Drejtori:- janë në dispozicion 8 makina dhe këto i kanë vetë subjektet.

Këshilltari Timoleo Gërdhuqi :- ka ndonjë ankesë me shkrim rreth firmave ? Jo ,nuk ka ,në rregull është realizuar pastrimi.

Zyra juridike:- lidhja e marrëveshjes kuadër ka patur sukses.

Këshilltarja Thëllëza Kokaveshi :- Ky fond si shpërndahet?

Drejtori Sokrat Kreku: fondi shërben për gjelbërimin, mirëmbajtjen e varrezave, riparimin, kusitje e të tj.

Këshilltar Artionil Shirokaj: - mbi ç'bazë paguhen punonjësit e varrezave? Në ligj firma private ka detyrum ligjor të jep pagë minimale?

Këshilltarja Afrovita Dhimojani : - sa punëtor ka firma Alko për pastrimin?

Këshilltar Gjergji Iliadhi: - sa herë i lani rrugët dhe i dizifiktoni?

Përgjegjësi ju përgjigjet pyetjeve të këshilltarëve.

Këshilltar Nikolin Laska: - me pastrimin jemi të kënaqur por kjo nuk do të thotë që nuk ka vend për përmirësim si disa mangësi në larjen e disa rrugëve.

Këshilltar Timoleo Gërdhuqi: - nuk më intereson se si e menaxhon firma pastrimin më intereson që bëhet pastrimi dhe unë jam i kënaqur në fshatin tim.

Këshilltarja Silva Burbo: - firmat e pastrimit duhet të bëjnë punën, të jenë më të organizuar si infektum, laje, pastrimi koshave e të tjerë sepse jeni ju që e nderoni ose e turpëroni Himarën sepse atëron sezoni turistik, tani në qytetin e Himarës është një kaos, pluhur, punime.

Firma e punimeve të ujërave të zeza na ka premtuar se do të mbyllen punimet para muaj maj (kryetari këshillit)

Këshilltar Milto Nika: - problemi I pastrimit është problem për të gjitha bashkitë, por bashkia e Himarës është shumë herë më mirë në pastrim, por ka punë për përmirësim, unë shoh makina në rrugën Borsh – Sarandë që hedhin mbeturina anës rrugës apo në rrugë do të doja të caktuhej një ligj për këtë përderisa njerëzit nuk janë të përgjegjshëm. Kam një vërejtje për përgjegjësit e firmave punonjësit i paguani nga shpërbirim minimal në maksimal.

Pika 3

Shqyrtimi i kërkesës së grupit të këshilltarëve koalicioni BF për kalimin e ujësjellësit Himarë me shoqërinë rajonale ujësjellës – kanalizime Sh. A, ku kërkojnë informacion nga drejtoria përkatëse, nga Kryetari Bashkisë, nga Këshilli Bashkiak, nga Drejtoria Juridike, për miratimin e këtij vendimi t'ju çohet në dispozicion e gjithë praktika e ndjekur. Si është realizuar marrëveshja mes Bashkive Himarë – Vlorë – Selenicë.

Këshilltarja Afrovita Dhimojani lexon projektvendimin e sjell për miratim në këshill në korrik të vitit 2023 i cili nuk është miratuar nga këshilli, po kështu edhe në muajin gusht nuk është marruar nga këshilli, kush e ka bërë këtë marrëveshje?

Sqaron zyra juridike: - për ta sqaruar, me vendim të Këshillit Bashkiak në vitin 2022 është bërë një marrëveshje me Këshillin e Ministrave dhe nëpërmjet komunikimeve inditucionale nga ku ka ardhë VKM-ja për miratim bashkëlidhur vendimin kemi marrëveshjen tip ku janë posqyrar saktë, është paraqitur marrëveshja dhe kryetari i bashkisë e ka firmosur dhe

institucioni i prefektit ka të drejtën për ligjshmérinë. Termi ligjor i miratimit përputhet me këtë marrëveshje. Këshilli I atëhershëm i ka dhënë ligjshmérinë kryetarit të Bashkisë për miratimin e kësaj marrëveshje,nëse mendoni se vullneti juaj është refuzuar drejtohuni organeve kompetente.

Këshilltarja Thëllëza Kokaveshi:- në momentin që është kundërshtuar nga ky këshill dhe ju nga ana ligjore e keni miratuar?

Kryetari këshillit:- të na jepin një informacion drejtori ish drejtori i ujësjellës.

Drejtori Andra Goro :- unë për këtë pikë nuk kam qënë dakort. Bashkimi është bërë në bazë të një VKM,nëse vendimi i vitit 2022 ka shkuar dhe i vitit 2023 nuk ka shkuar atëherë ka diçka këtu .

Me këtë vendim nuk kemi mundësi vendimmarrje ,thesar,buxhet,çështja është ligjore.Unë parashtroj një behar të vështirë për ujë.

Këshillari Fuat Mati : ky vendim na dëmton si Bashki,ne morëm vendim për jo ,dhe është bërë dëgjesë publike për këtë temë ? Bëhet një investim në fshatin tim dhe dua të kem projektin ,sa është marrë parasysh pjesa e ndarjes së ujërave tokësore ,sa do të vuditjen,nga bashkia është marr leje me shkrim për punimet ,mesa di dëgjesa nuk janë bërë,burimi kryesor i ujit është në vend tjetër dhe tabela është çuar diku tjetër ,kërkoi projektin,marrëveshjen,konratën në fshatin Borsh.

Këshillari Qirjako Mërkuri :-kush i bën këto projekte ,kërkojmë shpjegim.

Drejtori Andra Goro :- ne si ujësjellës nuk kemi përgjegjësi.

Zyra juridike:- ja delegon armiqësore dhe Prefektit.

Këshilltarja Afrovita Dhimojani:- jemi të gjithë të qartë që këtu është një abuzim i hapur.

Znj.kryetare :- çfarë sugjeroni ju si Bashki?

Kryetari Znj.Blerina Bala:- unë këtë çështje e kam gjetur të mbartur ,në pozicionin e nënkryetares që kam mbajtur detyrat i kemi të ndara,nuk jam në dijeni të kësaj çështje.

Drejtori Andrea Goro:- për ujin e Kalit kërkojmë një rezervuar në Borsh për të marr ujin.

Këshilltarji Timoleo Gërdhuqi:- Me këtë marrëveshje,me vendim të Këshillit të vitit 2022 ,pse tre fshatra kanë ngelur jashtë? Kërkoi vendimin e Këshillit të vitit 2022 ujësjellësin,kërkoi nga prefekitura se si përfshihet ky audit?

Këshilltarja Silva Burbo:- mbi bazën e cilit dokument funksionin ujësjellësi sot?

Drejtori :- mbi bazën e marrëveshjes që është bërë.

Kryetari këshillit kërkon dhjetë min pushim për të diskutuar me këshillin rrëth vendimmarrjes së kësaj çështje.

Kryetari këshillit:- vazhdojmë mbledhjen...

I kam bëre një kërkesë akumit mbi ujësjellësin e fshatit Kuç,ku investimi ka përfunduar dhe banorët nuk kanë ujë

Duaam një shpjegim për këtë ujësjellës.

Merr lejen kryeplaku i fshatit Kuç- qëndër Astrit Balilaj,60 familje nuk janë futur në projekt është ky ujësjellës nuk funksionon.

Sqaron administratori njësisë Z.Gramoz Balilaj:- Lidhja e kontratës me drejtorinë e ujësjellës për fshatin Tërbap është funksionale janë me sahat ,nuk kanë kontratë.Kuç- buronjë janë vendosur sahatë janë normal.Kuçi qëndër është me probleme.Bolena ka ujë ,po ashtu dhe Vranishti kanë ujë,ne nuk jemi me shoqërinë Sh.A jemi me Bashkinë Himarë.

Këshilltarja Afrovita Dhimojani:- pasi diskutuam pikën për ujësjellësin në lidhje me shkeljen e kësaj ligjshmërie ne dolëm në përfundimin me vendim “ Për shprehje të vullnetit të Këshillit Bashkiak për anulimin e kontratës nr.3252 datë 13.07.2023 të protokolluar nr.5946 datë 14.07.2022 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, lidhur midis Bashkisë Himarë ,Bashkisë Vlorë,Bashkisë Selenicë dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë ,me objekt “ marrëveshje për krijimin e subjektit të kopetencave të përbashkëta të ujësjellës kanalizime” kongluzioni:- e lidhur në kundërshtim me vendimin e Këshillit Bashkiak Himarë datë 21.07.2023,Nr 27.

Kryetari këshillit : Jeni dakort ta hedhim në votim?

Këshilli:- jemi dakort!

Miratohet vendimi nr .12 mbi kërkesën e këshilltarëve me 13 vota pro,1 kundër (Dh.Kapaj) zero abstenim.

Pika 2 e kërkesës.

Kërkjmë fillimin e procedurave ligjore civile për zgjidhjen gjyqësish të kontratës nr 3252 datë 13.07.2023

Kryetari këshillit:- jeni dakort edhe për kërkesë ta hedhim në votim?

Këshilli :-jemi dakort!

Miratohet kërkesa me nr. Vendimi 13, dhe 13 këshilltar janë pro,1 kundër (Dh.Kapaj) zero abstenim.

Pika 3 e kërkesës.

Kërkesë për auditim drejtar KLSH për procedurat e lidhjes së kësaj kontrate.

Miratohet vendimi nr.14 me 13 vota pro ,1 kundër (Dh.Kapaj) zero abstenim

Pika 4 e rendit të ditës.

Miratohet vendimi nr .15 mbi dhënen e ndihmës ekonomike 6% me 14 vota pro, 0 kundër ,0 abstenim.

Të udryshme

Shqyrtobet kërkesa e Z. Marsin Gocaj: është i pranishëm në mbledhje dhe kërkon nga këshilli miratum fondi për hedhjen e soletës së shtëpisë.

Kryetari këshillit: nuk është në kompetencën tonë.

Shqyrtimi i kërkesës së Z. Aleks Bala: - është i pranishëm në sallë dhe merr të drejtën e fjalës. Në fshatin Pilur më kanë marr pronën për panele diellore kompania Prospekt.

Kryetari këshillit:- do të kërkojmë procedurën se si është praktikuar.

Këshilltari Qirjako Mërkuri :- të verifikohet çështja nga drejtoria përkatëse dhe këshilli të sjell atë vendin.

Këshilltari Timoleo Gërdhuqi: në emër të grupit dhe banorëve në fshatin Borsh po priten pyje dhe bëhen rrëthime ,kërkojmë ku është marr kjo leje,gjithë praktikën.

Këshilltarja Afrovita Dhimojani :- janë bërë dy dëgjesa publike në Himarë ku janë bërë vërejtje nga banorët se do gë zhvillohen linja inertë ,kjo kërkesë lidhet me shqetësimin e banorëve në dy lagjet e qytetit të Himarës me subjektin Himara Konstruktion sh.p.k për ushtrim aktiviteti në inerte dhe kërkojnë për të marr leje mjedisore më një vend të banuar.

Kryetari Bashkisë Znj.Blerina Bala:- ndaj bëhen dëgjesat publike për të marr reagimin dhe mendimin e qytetarëve ,nuk kemi marr vendim.

Shqyrtimi i kërkesës së banorëve në një lagje Bolenë

Shtrim rruge në lagjen " hundë e xhepe" ku banojnë 8 familje.

Kërkesa do të kaloj për shqyrtim drejtorisë përkatëse.

Kryetari këshillit mbyll mbledhjen . Mirë u takofshim në mmliddhjen e radhës!

Sekretari Këshillit

Elena Memushaj

